

PHILIPS

Orë radio

Seria 4000

TAR4650



Manuali i përdorimit

Regjistroni produktin tuaj dhe merrni ndihmë në:
www.philips.com/support

Përmbajtja

1 E rëndësishme	2	6 Dëgjimi i radios FM	10
Siguria	2	Kalimi nëpër stacionet FM	10
2 Ora radio	3	Ruajtja automatikisht e stacioneve të radios FM	10
Hyrje	3	Ruajtja manualisht e stacioneve të radios FM	10
Çfarë ka në kuti	3	Zgjedhja e një stacioni radioje të ruajtur	10
Përmbledhje e orës radio	4	Shfaqni menunë në modalitetin FM	11
3 Fillimi	5	Shfaqja e informacioneve RDS	11
Instalimi i baterive	5	7 Veçori të tjera	12
Lidhja me energjinë	5	Porta USB e tipit C për karikim të jashtëm	12
Ndizeni/kalojeni në gjendjen e pauzës	5	8 Të dhënat e produktit	12
Rregullimi i volumnit	5	9 Zgjidhja e problemeve	13
Rregullimi i ndriçimit të ekranit	5	10 Njoftim	13
4 Vendorsja e orës dhe alarmit	6	Pajtueshmëria	13
Vendorsja automatike e orës	6		
Vendorsja manuale e orës	6		
Shfaq menunë	6		
Vendorsja e orës së alarmit	7		
Aktivizimi/çaktivizimi i alarmit	7		
Shtyjeni alarmin	7		
Ndaloni tingujt e alarmit	7		
Vendorsja e kohëmatësit të gjumit	7		
5 Dëgjimi i radios DAB	8		
Kalimi nëpër stacionet DAB	8		
Ruani stacionet radiofonike DAB	8		
Zgjedhja e një stacioni radioje të ruajtur	8		
Shfaqja e informacioneve DAB	9		
Shfaqni menunë në modalitetin DAB	9		

1 E rëndësishme

Siguria

- Lexoni këto udhëzime.
- Përbajuni të gjitha paralajmërimeve.
- Ndiqni të gjitha udhëzimet.
- Mos i bllokoni hapësirat e ajrimit. Instalojeni sipas udhëzimeve të prodhuesit.
- Mos e instaloni pranë asnjë burimi nxehtësie, si për shembull pranë radiatorëve, rrugëdaljeve të ngrohjes, sobave ose pajisjeve të tjera (duke përfshirë amplifikatorët) që prodhojnë nxehtësi.
- Mbrojeni kordonin e energjisë në mënyrë që të mos shkelet ose kafshohet, sidomos pranë spinave, prizave dhe në pikën ku dalin nga ora radio.
- Përdorni vetëm pjesë/aksesorë që janë specifikuar nga prodhuesi.
- Shkëputeni pajisjen kur ka stuhi ose kur nuk përdoret për periudha të gjata kohe.
- Të gjitha riparimet duhet të bëhen nga personat e kualifikuar të servisit. Riparimet duhen bërë kur pajisja është dëmtuar në ndonjë mënyrë, si për shembull kur kordoni i energjisë ose spina është dëmtuar, kur janë derdhur lëngje ose kanë rënë objekte brenda pajisjes, kur pajisja është ekspozuar ndaj shiut ose lagështisë, kur nuk punon normalisht ose kur është rrëzuar.
- KUJDES lidhur me përdorimin e baterisë - Për të mos lejuar rrjedhjet e baterive të cilat mund të shkaktojnë lëndime, dëmtime të pronës, ose dëmtime të orës radio:
- Mos i përzieni bateritë e vjetra me të reja. Mos i përzieni bateritë alkaline, standarde (karbon-zink) ose të rikarikueshme (ni-cad, ni-mh, etj.).
- KUJDES: Rrezik shpërthimi nëse bateritë nuk vendosen si duhet. Ndërrojeni vetëm me bateri të njëjtë ose me të njëjtin tip.
- Bateria në temperatura ekstremisht të larta ose të ulëta gjatë përdorimit, ruajtjes ose transportit dhe presioni i ulët i ajrit në lartësi të mëdha mund të paraqesin rreziqe sigurie.
- Mos e ndërroni baterinë me një tip të gabuar (për shembull, disa lloje baterish litiumi).
- Lënia e baterisë në temperaturë tepër të lartë, ose në presion atmosferik tepër të ulët mund të shkaktojë shpërthim ose rrjedhje të lëngjeve ose gazrave të djegshëm.
- Montojini të gjitha bateritë si duhet, + dhe - siç janë shënuar në aparat.
- Hiqni bateritë nëse ato janë shkarkuar ose nëse telekomanda (nëse përfshihet) nuk do të përdoret për një kohë të gjatë.
- Bateritë përmbajnë substanca kimike. Ato duhet të asgjësohen në mënyrë korrekte.
- Nëse dyshoni se një bateri është gëlltitur ose është futur në ndonjë pjesë të trupit, kërkoni menjëherë ndihmë mjekësore.
- Kur ndërroni bateritë, mbajini gjithnjë bateritë e reja dhe ato të përdorura larg fëmijëve. Sigurohuni që vendi i baterisë të jetë krejt i sigurt pasi ta ndërroni baterinë.
- Nëse vendi i baterisë nuk mund të sigurohet komplet, mos e përdorni më produktin. Mbajeni larg fëmijëve dhe kontakti prodhuesin.
- Kjo orë radio nuk duhet të ekspozohet ndaj pikave ose spërkatjeve.
- Mos vendosni asnjë burim rreziku mbi orën radio (p.sh. objekte të mbushura me lëngje, qirinj të ndezur).
- Aty ku spina e energjisë të adaptorit direkt Plug-in përdoret si mjet shkëputjeje, pajisja e shkëputjes duhet të jetë në një vend që arrihet me lehtësi.
- Ju lutemi përdorni produktin në mënyrë të sigurt në një mjedis me temperaturë ndërmjet 0° dhe 45°.

2 Ora radio

Urime për blerjen tuaj, dhe mirë se vini në Philips! Për të përfituar plotësisht nga mbështetja që jep Philips, regjistroni produktin në www.philips.com/support.

Hyrje



Me këtë orë radio, ju

- mund të dëgjoni radio me transmetim FM dhe Digital Audio Broadcasting (DAB)
- mund të vendosni dy alarme që të bien në orare të ndryshme;
- karikoni pajisjet tuaja celulare.

Çfarë ka në kuti

Kontrolloni dhe dalloni gjërat që ka në kuti:


- Njësia kryesore
- Adaptor i energjisë
- Shumëkablë
- Udhëzues për fillimin e shpejtë
- Fletë sigurie
- Garancia



Shënim

- Sasia dhe lloji i prizës së furnizuesit të energjisë mund të ndryshojë sipas zonave.
- Imazhet, ilustrimet dhe vizatimet që tregohen në këtë manual përdorimi janë vetëm për referencë, produkti i vërtetë mund të ndryshojë në pamje.

Përmbledhje e orës radio



- ① **⏻ / DAB / FM**
 - Ndizeni ose kalojeni në gjendje joaktive.
 - Kaloni në burimin DAB/FM.
- ② **VOL +**
 - Rregullimi i volumnit.
- ③ **HOUR / TUN –**
 - Vendosni orën.
 - Sintonizohuni me një stacion radioje.
 - Zgjidhni stacionin e mëparshëm të ruajtur.
 - Zgjidhni një opsion në meny.
- ④ **ALR 1**
 - Vendosni alarmin.
- ⑤ **PRESET/BACK**
 - Ruani stacionet e radios në memorie.
 - Zgjedhja e një stacioni radioje të ruajtur.
 - Kthehuni te menya e mëparshme.
 - Dilni nga cilësimi i menysë.
- ⑥ **SCAN / ENTER**
 - Skanoni dhe ruani automatikisht stacionet e radios.
 - Hyni në listën e artikujve të zgjedhur të menysë.
- ⑦ **VOL –**
 - Rregullimi i volumnit.
- ⑧ **SNOOZE / BRIGHTNESS**
 - Shtyni alarmin.
 - Rregullimi i ndriçimit të ekranit.
- ⑨ **SLEEP**
 - Vendosni kohëmatësin e gjumit.
- ⑩ **MENU / INFO**
 - Hyni në cilësimet e menysë.
 - Shfaq informacionin.
- ⑪ **ALR 2**
 - Vendosni alarmin.
- ⑫ **MIN / TUN +**
 - Vendosni minutat.
 - Sintonizohuni me një stacion radioje.
 - Zgjidhni stacionin tjetër të ruajtur paraprakisht
 - Zgjidhni një opsion në meny.
- ⑬ **Ekrani**
 - Shfaqni statusin aktual.
- ⑭ **Porta USB e tipit C për karikim të jashtëm**
 - Karikoni pajisjet tuaja celulare.
- ⑮ **DC IN**
 - Lidhuni me adaptorin e energjisë.
- ⑯ **Antenë DAB / FM**

3 Fillimi

Ndigni gjithnjë me radhë udhëzimet në këtë kapitull.


Instalimi i baterive

Bateritë mund të ruajnë vetëm parametrat për orën dhe alarmin.



Kujdes

- Rrezik shpërthimi! Mbjajni bateritë larg nga nxehtësia, drita e diellit ose zjarri. Asnjëherë mos i hidhni bateritë në zjarr.
- Bateritë përmbajnë substanca kimike, ndaj duhet të hidhen si duhet.
- Mos përzies lloje të ndryshme baterish: p.sh., alkaline me zink karboni. Përdorni vetëm bateri të të njëjtit lloj për pajisjen.



- 1 Hapni ndarjen e baterisë në fund të njësisë.
- 2 Vendosni 2 copë bateri AAA (nuk pwrifshihen) me polaritetin e duhur (+/-) siç tregohet, më pas mbyllni ndarjen e baterisë.

Lidhja me energjinë



Kujdes


- Rrezik i dëmtimit të produktit! Sigurohuni që tensioni i energjisë të përputhet me tensionin që tregohet mbrapa ose poshtë orës radio.
- Rrezik goditjeje elektrike! Kur hiqni kablloin e energjisë, gjithmonë tërhiqni prizën nga kontakti. Asnjëherë mos tërhiqni kordonin.



Shënim

- Etiketa e të dhënave ndodhet poshtë orës radio.

Lidhni përshtatësin e rrymës me prizën në mur.



Shënim

- Sasia dhe lloji i prizës së furnizuesit të energjisë mund të ndryshojë sipas zonave.
- Imazhet, ilustrimet dhe vizatimet që tregohen në këtë manual përdorimi janë vetëm për referencë, produkti i vërtetë mund të ndryshojë në pamje.

Ndizeni/kalojeni në gjendjen e pauzës

- Shtypni  për të ndezur njësinë.
↳ Radio kalon në burimin e fundit të zgjedhur.
- Shtypni  për 3 sekonda për të kaluar njësinë në modalitetin e pauzës.
↳ Shfaqen ora dhe data (nëse janë vendosur).

Rregullimi i volumnit

Ndërsa dëgjoni, shtypni **VOL + / VOL -** për të rregulluar volumnin.

Rregullimi i ndriçimit të ekranit

Shtypni **BRIGHTNESS** për të zgjedhur nivele të ndryshme ndriçimi ose për të fikur ekranin:

- High (Lartë)
- Medium (Mesatare)
- Low (Ulët)
- Off (Fikur)

4 Vendosja e orës dhe alarmit

Vendosja automatike e orës

- 1 Shtypni **MENU** për të hyrë në cilësimet e orës.
- 2 Shtypni **ENTER** për të hyrë në opsionin <Set Date&Time>
- 3 Shtypni **TUN + / TUN** – për të zgjedhur <Auto>, më pas shtypni **ENTER** për ta konfirmuar.
- 4 Shtypni **BACK** për të dalë nga modaliteti i konfigurimit.

Në stacionin DAB/FM RDS, pajisja mund të sinkronizohet automatikisht me kohën e transmetuar nga stacioni DAB/FM RDS (me informacionin CT).

Vendosja manuale e orës

- 1 Shtypni **MENU** për të hyrë në cilësimet e orës.
- 2 Shtypni **ENTER** për të hyrë në opsionin <Set Date&Time>
- 3 Shtypni **TUN + / TUN** – për të zgjedhur <Manual>, më pas shtypni **ENTER** për ta konfirmuar, muaji do të pulsojë.
- 4 Shtypni **TUN + / TUN** – për të vendosur muajin, më pas shtypni **ENTER** për ta konfirmuar, dita do të pulsojë.
- 5 Shtypni **TUN + / TUN** – për të caktuar ditën, më pas shtypni **ENTER** për ta konfirmuar, viti do të pulsojë.
- 6 Shtypni **TUN + / TUN** – për të vendosur vitin, më pas shtypni **ENTER** për ta konfirmuar, ora do të pulsojë.
- 7 Shtypni **hour** për të vendosur orën dhe shtypni **MIN** për të vendosur minutat, më pas shtypni **ENTER** për ta konfirmuar.
↳ Ora është vendosur.
- 8 Shtypni **BACK** për të dalë nga modaliteti i konfigurimit.

Vendosja e formatit kohor

- 1 Shtypni **MENU** për të hyrë në cilësimet e orës.
- 2 Shtypni **TUN + / TUN** – për të zgjedhur <Time Format>, më pas shtypni **ENTER** për ta konfirmuar.
- 3 Shtypni **TUN + / TUN** – për të vendosur formatin e orës <12H>/<24H>, më pas shtypni **ENTER** për ta konfirmuar.
- 4 Shtypni **BACK** për të dalë nga modaliteti i konfigurimit.

Vendosja e formatit të datës

- 1 Shtypni **MENU** për të hyrë në cilësimet e orës.
- 2 Shtypni **TUN + / TUN** – për të zgjedhur <Date Format>, më pas shtypni **ENTER** [Hyj] për ta konfirmuar.
- 3 Shtypni **TUN + / TUN** – për të vendosur formatin e datës <MM-DD-YYYY>, <DD-MM-YYYY> ose <YYYY-MM-DD>, më pas shtypni **ENTER** për ta konfirmuar.
- 4 Shtypni **BACK** për të dalë nga modaliteti i konfigurimit.



Shënim


- Nëse asnjë buton nuk shtypet për rreth 30 sekonda, pajisja del automatikisht nga modaliteti i vendosjes së orës.
- Shtypni dhe mbani të shtypur **BACK** për 3 sekonda për të dalë nga modaliteti i cilësimit të kohëmatësit pa ruajtur ndryshimin.

Shfaq menunë

Kur njësia është në modalitetin e pauzës, mund të përdorni menyën për opsionet e kontrollit.

- 1 Shtypni **MENU** për të hyrë në cilësimin e orës.
- 2 Shtypni **TUN + / TUN** – për të zgjedhur një opsion të menysë dhe më pas shtypni **ENTER** për të konfirmuar zgjidhjen ose për të hyrë në menyën e nivelit më të ulët.
 - **[Set Date&Time]**: për të caktuar datën, orën.
 - **[Time Format]**: për të zgjedhur formatin e kohës.
 - **[Date Format]**: për të zgjedhur formatin e datës.
- 3 Përsëritni hapin 2 nëse ndonjë nën-opsion është i disponueshëm brenda një opsioni të caktuar.
- 4 Shtypni **BACK** për t'u kthyer në menyën e mëparshme ose për të dalë nga menya.

Clock setting



Shënim

- Nëse nuk shtypet asnjë buton brenda 30 sekondash, menya mbyllet vetë.
- Shtypni dhe mbani të shtypur **BACK** për 3 sekonda për të dalë nga menya.

Vendosja e orës së alarmit



Shënim

- Sigurohuni që ta keni vendosur orën si duhet.

- 1 Shtypni dhe mbani shtypur **ALR 1** ose **ALR 2** për 3 sekonda për të aktivizuar modalitetin e konfigurimit të alarmit, ikona ose dhe koha e alarmit do të pulsojnë.
- 2 Shtypni **HOOR** për të vendosur orën dhe shtypni **MIN** për të caktuar minutat, më pas shtypni **ALR 1** ose **ALR 2** për ta konfirmuar, ikona ose periudha e alarmit do të pulsojnë.
- 3 Shtypni **TUN + / TUN -** për të zgjedhur periudhën e alarmit [ONCE (NJË HERË), DAILY (PËRDITË), WEEKDAY (DITË PUNE), WEEKEND (FUNDJAVË)], më pas shtypni **ALR 1** ose **ALR 2** për ta konfirmuar, ikona ose dhe burimi i alarmit do të pulsojnë.
- 4 Shtypni **TUN + / TUN -** për të zgjedhur burimin e alarmit (sinjalizuesi zanor/bipi, DAB ose stacion FM), më pas shtypni **ALR 1** ose **ALR 2** për ta konfirmuar.
 - Nëse DAB ose FM zgjidhet si burim alarmi, ikona ose dhe numri i stacionit të caktuar paraprakisht do të pulsojë, shtypni **TUN + / TUN -** për të zgjedhur stacionin radiofonik të paracaktuar DAB ose FM, më pas shtypni **ALR 1** ose **ALR 2** për ta konfirmuar.



Këshillë

- Pajisja del nga modaliteti i vendosjes së alarmit kur nuk bëhet asnjë veprim për 30 sekonda.
- Nëse zgjidhet burimi i alarmit DAB/FM dhe stacioni nuk është i vendosur paraprakisht, sinjalizuesi zanor/bip aktivizohet automatikisht.
- Kohëzgjatja e e alarmit është 60 minuta nëse nuk kryhet asnjë veprim nga përdoruesi.

Aktivizimi/çaktivizimi i alarmit

Shtypni **ALR 1** ose **ALR 2** për të aktivizuar ose çaktivizuar kohëmatësin e alarmit.

- ↳ Me aktivizimin e kohëmatësit të alarmit, do të shfaqen ikona ose dhe informacioni i alarmit.
- ↳ Nëse kohëmatësi i alarmit është çaktivizuar, ikona ose dhe informacioni i alarmit do të fiken.

Shtyjeni alarmin

Kur bie alarmi, shtypni **SNOOZE**.

- ↳ Alarmi shtyhet dhe bie përsëri 10 minuta më vonë.
- Gjatë kohës së shtyrjes së alarmit, shtypni **SNOOZE** për të zgjedhur një periudhë tjetër (në minuta) deri sa alarmi të fillojë përsëri.

10 → 20 → 30 → 40 → 50 → 60
↑

Ndaloni tingujt e alarmit

Me rënien e alarmit, shtypni **ALR 1** ose **ALR 2** përkatës.

- ↳ alarmi ndalon por cilësimet e alarmit mbeten.

Vendosja e kohëmatësit të gjumit

Kjo orë radio mund të kalojë automatikisht në gjendje joaktive pas një periudhe të caktuar.

- Shtypni **SLEEP** për të zgjedhur një periudhë (në minuta).
 - ↳ Ora radio kalon automatikisht në gjendje joaktive pas periudhës së caktuar.

15 → 30 → 60 → 90 → 120
↑ OFF

Për ta çaktivizuar kohëmatësin e gjumit:

- Shtypni vazhdimisht **SLEEP** derisa të shfaqet [OFF] (fikur).

5 Dëgjimi i radios DAB



Shënim

- Mbajeni orën radio larg nga pajisjet e tjera elektronike për të shmangur interferencat e radios.
- Për marrje më të mirë të sinjalit, shtrijeni plotësisht dhe rregulloni pozicionin e DAB / FM antenës.

Kalimi nëpër stacionet DAB

Herën e parë që zgjidhni modalitetin e radios DAB, ose nëse lista e stacioneve është bosh, radio kryen automatikisht një skanim të plotë

- Shtypni **DAB / FM** për të zgjedhur modalitetin DAB.
 - ↳ Shfaqet mesazhi [Scanning].
 - ↳ Radioja skanon dhe ruan automatikisht të gjitha stacionet radio DAB dhe më pas transmeton stacionin e parë të disponueshëm.
 - ↳ Lista e stacioneve ruhet e memorizuar në radio.
Herën tjetër me ndizjen e radios, skanimi i stacioneve nuk do të kryhet më.

Për të shkuar në një stacion në listën e stacioneve të disponueshme:

- 1 Shtypni **TUN + / TUN –** për të lundruar nëpër stacionet e disponueshme DAB.
- 2 Shtypni **ENTER** për ta konfirmuar.



Këshillë

- Stacionet mund të ndryshojnë herë pas here. Për të përditësuar listën e stacioneve, shtypni dhe mbani të shtypur **SCAN** për 3 sekonda për të kryer skanimin e plotë.

Ruani stacionet radiofonike DAB



Shënim

- Mund të ruani deri në 20 stacione radioje DAB.

- 1 Në modalitetin DAB, sintonizoni një stacion radioje DAB.
- 2 Mbani shtypur **PRESET** për 3 sekonda për të aktivizuar modalitetin e programimit.
 - ↳ Shfaqet "Preset Store".
 - ↳ Numri i ruajtur fillon të pulsojë.
- 3 Shtypni **TUN + / TUN –** për të zgjedhur një numër të caktuar.
- 4 Shtypni përsëri **PRESET** për të konfirmuar.
 - ↳ Shfaqet "Stored".
 - ↳ Stacioni ruhet në pozicionin e zgjedhur.
- 5 Përsëritni hapat 1 deri në 4 për të ruajtur stacione radioje DAB të tjera.



Këshillë

- Për ta fshirë një stacion të ruajtur, ruani një stacion tjetër në vend të tij.

Zgjedhja e një stacioni radioje të ruajtur

Zgjidhja A:

Në modalitetin DAB, shtypni **PRESET** për të zgjedhur një numër të paracaktuar.

Zgjidhja B:

- 1 Në modalitetin DAB, shtypni **PRESET**.
- 2 Shtypni **TUN + / TUN –** për të zgjedhur një stacion radioje të përcaktuar paraprakisht.



Shënim

- Pas 3 sekondash, stacioni i radios të përcaktuar paraprakisht do të konfirmohet në mënyrë automatike

Shfaqja e informacioneve DAB

Nërkohë që dëgjoni radion DAB, shtypni dhe mbani **INFO** të shtypur për 3 sekonda për të shfaqur informacionin e mëposhtëm (nëse është i disponueshëm):

- ↳ DAB ose DAB+
- ↳ Emri i stacionit
- ↳ Teksti në lëvizje
- ↳ Lloji i programit
- ↳ Emër i shumëfishtë
- ↳ Kanal
- ↳ Frekuenca
- ↳ Modaliteti: Shpejtësia e transferimit
- ↳ Modaliteti: Lloji i kanalit
- ↳ Cilësia e sinjalit

- 3 Përsëritni hapin 2 nëse ndonjë nën-opcion është i disponueshëm brenda një opsioni të caktuar.
- 4 Shtypni **BACK** për t'u kthyer në menyë e mëparshme ose për të dalë nga menyja.



Shënim


- Nëse nuk shtypet asnjë buton brenda 30 sekondash, menyja mbyllet vetë.
- Shtypni dhe mbani shtypur **BACK** për 3 sekonda për të dalë nga menyja.

Shfaqni menunë në modalitetin DAB

Kur dëgjoni DAB, mund të të hyjni në meny për opsionet e kontrollit.

- 1 Shtypni **MENU** për të hyrë në menyë DAB.
- 2 Shtypni **TUN + / TUN -** për të zgjedhur një opion të menysë dhe më pas shtypni **ENTER** për të konfirmuar zgjidhjen ose për të hyrë në menyë e nivelit më të ulët.
 - **[Full scan]**: për të kryer skanimin e plotë
 - **[Manual tune]**: sintonizohuni për të vendosur manualisht një kanal/frekuençë specifike dhe për ta shtuar atë në listën e stacioneve
 - **[Prune]**: fshini të gjitha stacionet e pavlefshme nga lista e stacioneve.
 - **[DRC level]**: ngjesh diapazonin dinamik të një sinjali radio, në mënyrë që volumi i tingujve të qetë të rritet dhe volumi i tingujve të lartë të uket.
 - **[Clock setting]**: për të vendosur datën, orën dhe për të kryer përzgjedhjen e formatit të orës dhe datës.
 - **[System]**: për shfaqjen e versionit aktual të firmuerit dhe për rivendosjen e të gjitha cilësimeve të radios në gjendjen fillestare të fabrikës.

DAB Menu



6 Dëgjimi i radios FM



Shënim

- Mbajeni orën radio larg nga pajisjet e tjera elektronike për të shmangur interferencat e radios.
- Për marrje më të mirë të sinjalit, shtrijeni plotësisht dhe rregulloni pozicionin e DAB / FM antenës.

Kalimi nëpër stacionet FM

- 1 Shtypni **DAB / FM** për të zgjedhur modalitetin FM.
- 2 Mbani shtypur **TUN + / TUN –** për 3 sekonda.
↳ Ora radio shkon automatikisht në një stacion Clock radio me sinjal të fortë.
- 3 Përsëritni hapin 2 për të shkuar në më shumë stacione radioje.

Për të shkuar manualisht në një stacion:

Shtypni **TUN + / TUN –** për të zgjedhur një frekuencë.



Shënim

- Rrjeti i sintonizimit të orës së radios është 50 kHz, frekuenca e radios në panelin e ekranit do të rritet me 0,05 MHz kur shtypni **TUN + / TUN –**.

Ruajtja automatikisht e stacioneve të radios FM

Në modalitetin e kërkimit FM, shtypni dhe mbani shtypur **SCAN** për më shumë se 3 sekonda.

- ↳ Pajisja ruan automatikisht të gjitha stacionet e radiove FM të disponueshme dhe transmeton stacionin e parë.



Shënim

- Mund të ruani deri në 20 stacione radioje FM.

Ruajtja manualisht e stacioneve të radios FM

- 1 Në modalitetin e sintonizuesit FM, sintonizohuni me një stacion radioje FM.
- 2 Mbani shtypur **PRESET** për 3 sekonda për të aktivizuar modalitetin e programimit.
↳ Numri i ruajtur fillon të pulsojë.
- 3 Shtypni **TUN + / TUN –** për të zgjedhur një numër të caktuar.
- 4 Shtypni përsëri **PRESET** për të konfirmuar.
- 5 Përsëritni hapat 1 deri në 4 për të ruajtur stacione radioje FM të tjera.



Këshillë

- Për ta fshirë një stacion të ruajtur, ruani një stacion tjetër në vend të tij.

Zgjedhja e një stacioni radioje të ruajtur

Zgjidhja A:

Në modalitetin e sintonizimit FM, shtypni **PRESET** për të zgjedhur një numër të ruajtur paraprakisht.

Zgjidhja B:

- 1 Në modalitetin e kërkimit FM, shtypni **PRESET**.
- 2 Shtypni **TUN + / TUN –** për të zgjedhur një stacion radioje të përcaktuar paraprakisht.




Shënim

- Pas 3 sekondash, stacioni i radios të përcaktuar paraprakisht do të konfirmohet në mënyrë automatike

Shfaqni menunë në modalitetin FM

Kur dëgjoni FM, mund të përdorni menunë për opsionet e kontrollit.

- 1 Shtypni **MENU** për të hyrë në menunë FM.
- 2 Shtypni **TUN + / TUN -** për të zgjedhur një opsion të menysë dhe më pas shtypni **ENTER** për të konfirmuar zgjidhjen ose për të hyrë në menunë e nivelit më të ulët.
 - **[Clock setting]**: për të vendosur datën, orën dhe për të kryer përzgjedhjen e formatit të orës dhe datës.
 - **[System]**: për shfaqjen e versionit aktual të firmuerit dhe për rivendosjen e të gjitha cilësimeve të radios në gjendjen fillestare të fabrikës.
- 3 Përsëritni hapin 2 nëse ndonjë nën-opsion është i disponueshëm brenda një opsioni të caktuar.
- 4 Shtypni **BACK** për t'u kthyer në menunë e mëparshme ose për të dalë nga menya.



Shfaqja e informacioneve RDS

RDS (Radio Data System) është një shërbim që u jep mundësi stacioneve FM të shfaqin informacione shtesë.

- 1 Sintonizohuni në një stacion RDS.
- 2 Shtypni dhe mbani shtypur **INFO** për 3 sekonda për të shfaqur informacionin e mëposhtëm (nëse ofrohet):
 - ↳ Emri i stacionit
 - ↳ Lloji i programit si [NEWS] (lajme), Frekuenca, [SPORT] (sport), [POP M] (muzikë pop)...
 - ↳ Ora
 - ↳ Tekst




Shënim

- Nëse nuk shtypet asnjë buton brenda 30 sekondash, menya mbyllet vetë.
- Shtypni dhe mbani shtypur **BACK** për 3 sekonda për të dalë nga menya.

7 Veçori të tjera

Porta USB e tipit C për karikim të jashtëm



Lidhni skajin me madhësi standarde të një kabloje USB (nuk vjen e përfshirë) me portën C të tipit USB në pjesën e pasme të njësisë dhe më pas lidhni skajin tjetër me portën e karikimit në pajisjen tuaj.

8 Të dhënat e produktit



Shënim

- Informacionet për produktin mund të ndryshohen pa njoftuar paraprakisht.

Amplifikatori

Fuqia output	RMS 700 mW @10% THD; Maks. 1,4 W
--------------	----------------------------------

Kërkimit

Rrezja e kërkimit (FM)	87,5-108 MHz
Gama e sintonizimit (DAB)	174-240 MHz (Brezi III)
Rrjeti i kërkimit	50 kHz
Ndjeshmëria - Mono, 26 dB S/R-verhouding	< 22 dBf
Shtrembërimi total harmonik	< 10%
Raporti sinjal-zhurmë	> 50 dBA

Porta e karikimit USB të tipit C

Port për karikim të jashtëm	5,0 V $\approx$ 2,0 A
-----------------------------	-----------------------

Informacione të përgjithshme

Furnizimi me energji	5,0 V $\approx$ 3,0 A
Konsumi i energjisë gjatë punimit	< 1,5 W
Konsumi i energjisë në gjendje joaktive	< 1 W
Përmasat (Gje x La x Tra)	103x103,5x103 mm
Pesha (Njësia kryesore)	375 g

9 Zgjidhja e problemeve



Paralajmërim

- Asnjëherë mos e hiqni kasën e produktit.

Për ta mbajtur garancinë të vlefshme, asnjëherë mos u mundoni ta riparoni vetë pajisjen. Nëse hasni probleme ndërsa përdorni pajisjen, kontrolloni pikat e mëposhtme para se të kërkonit shërbime. Nëse problemi mbetet i pazgjidhur, shkoni në faqen e internetit të Philips www.philips.com/support. Kur kontaktoni Philips, sigurohuni që pajisja është pranë dhe të keni gati numrin e modelit dhe numrin e serisë.

Nuk ndizet

- Sigurohuni që spina e energjisë AC të pajisjes të jetë lidhur si duhet.
- Sigurohuni që ka energji në prizën AC.

Nuk ka zë

- Rregulloni volumnin.

Pajisja nuk përgjigjet.

- Shkëputeni dhe lidheni përsëri spinën e energjisë AC, pastaj ndizeni pajisjen përsëri.

Marrje e dobët e sinjalit

- Mbajeni orën radio larg nga pajisjet e tjera elektronike për të shmangur interferencat e radios.
- Zgjateni plotësisht dhe lëvizni pozicionin e antenës.

Alarmi nuk punon

- Vendoseni si duhet orën/alarmin.

Ora/alarmi fshihet

- Është ndërprerë energjia ose është shkëputur kordoni i energjisë.
- Vendoseni përsëri orën/alarmin.
- Zëvendësoni bateritë rezervë.

10 Njoftim

Pajtureshmëria

Çdo ndryshim ose modifikim i bërë në këtë pajisje që nuk është miratuar shprehimisht nga MMD Hong Kong Holding Limited mund ta bëjë të pavlefshme autoritetin e përdoruesit për ta përdorur produktin.

Nëpërmjet këtij dokumenti, TP Vision Europe B.V. deklaron se produkti është në përputhje me kërkesat thelbësore dhe dispozitat e tjera përkatëse të Direktivës RED 2014/53/EU dhe Rregullores SI 2017 Nr 1206 të Pajisjeve Radio të MB. Mund ta gjeni deklaratën e konformitetit në www.philips.com/support.



Produkti u përmbahet kërkesave të Komitetit Evropian për interferencat radio.



Ky produkt është bërë dhe është prodhuar me materiale dhe komponentë të cilësorisë së lartë, të cilët mund të riciklohen dhe ripërdoren.



Ky simbol do të thotë se produkti nuk duhet të hidhet bashkë me mbetjet shtëpiake, por duhet të çohet në një pikë të përshtatshme grumbullimi për riciklim. Ndiqni rregullat lokale dhe asnjëherë mos e hidhni produktin dhe bateritë e karikueshme së bashku me mbeturinat e zakonshme shtëpiake. Hedhja e duhur e produkteve të vjetra dhe e baterive të karikueshme ndihmon në parandalimin e pasojave negative ndaj mjedisit dhe shëndetit të njeriut.



Ky simbol nënkupton se produkti përmban bateri që mbulohen nga Direktiva Evropiane (EU) 2023/1542 të cilat nuk mund të asgjësohen së bashku me mbetjet e zakonshme shtëpiake. Informohuni rreth sistemit lokal të mbledhjes së veçantë për produktet elektrike dhe elektronike dhe për bateritë. Ndiqni rregullat vendëse dhe asnjëherë mos e hidhni produktin dhe bateritë së bashku me mbetjet e zakonshme shtëpiake. Hedhja e duhur e produkteve të vjetra ndihmon në parandalimin e pasojave negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.



MMD Hong Kong Holding Limited. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Specifikimet mund të ndryshohen pa u njoftuar.

Philips dhe Philips Shield Emblem janë marka tregtare të regjistruara të Koninklijke Philips N.V. dhe përdoren me licencë. Ky produkt është prodhuar nga, dhe shitet nën përgjegjësinë e MMD Hong Kong Holding Limited, ose të një prej filialeve të tij, dhe MMD Hong Kong Holding Limited është garantuesi i vetëm në lidhje me këtë produkt.